

PROGRAM I STUDIMIT 2-VJEÇAR ME KARAKTER PROFESIONAL

“EDUKATORË PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME (0-3 vjeç)”

Emërtimi akademik i studimit	DIPLOMË PROFESIONALE NË“EDUKATORË PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME (0-3 VJEÇ)”
Cikli i studimit	Program studimi 2-vjeçar me karakter profesional
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Në proces akreditimi
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi i studentëve në programet me karakter profesional, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional. b. Në këtë program studimi nota mesatare nuk është kriter pranimi. c. Renditja e kandidatëve fitues kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura. d. Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania).

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi themelor i programit të studimit **“Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme” (0–3 vjeç)** është t’i aftësojë studentët për veprimtari cilësore me fëmijët e moshës 0–3 vjeç. Studentët, përmes këtij programi, do të përgatiten në aspektin teorik dhe praktik në fushën e edukimit dhe zhvillimit të hershëm të fëmijës. Ata do të aftësohen të komunikojnë me fëmijët dhe të rriturit, duke përcaktuar në mënyrë të drejtë objektivat për të zhvilluar dhe analizuar në mënyrë kritike veprimtarinë e tyre. Lëndët e përzgjedhura në programin e studimeve për edukimin dhe zhvillimin e hershëm u ofrojnë mundësi studentëve që të përvetësojnë njohuri profesionale dhe praktike në shumë fusha të veprimtarisë edukative në fëmijërinë e hershme.

Për të arritur këto kompetenca profesionale, kursi 2-vjeçar artikulon ofertën formuese në kompetenca teorike thelbësore (të natyrës pedagogjike, psikosociale, antropologjike), për të kuptuar kushtet e fëmijërisë së hershme në shoqërinë bashkëkohore dhe modelet kryesore të ndërhyrjes pedagogjike dhe didaktike ekzistuese, si dhe kompetenca praktike funksionale për zhvillimin e proceseve edukuese në kontekstet e përmendura.

Vëmendje të veçantë u jepet kompetencave të natyrës didaktike, për t’u dhënë mundësi edukatorëve të përdorin instrumentet e përshtatshme në projektimin dhe programimin edukativ, i cili lidhet me kompetencat që nevojiten për analizën e nevojave edukative individuale dhe në grup të fëmijëve. Ky kurs synon të transmetojë kompetenca të cilat do t’u shërbejnë edukatorëve të ndërtojnë marrëdhënie dhe të dialogojnë me realitete të ndryshme familjare, duke ushtruar funksione direkte dhe indirekte në mbështetjen e prindërimit.

Përgjatë formimit që do të ofrohet nëpërmjet këtij kursi, peshë të veçantë u është kushtuar kompetencave që lidhen me praktikën, e cila do të zhvillohet në formën e laboratorëve formues profesionalë, në struktura të ndryshme që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, që veprojnë në nivel kombëtar dhe/ose në mjediset e universitetit, në formë simulimesh, projektimesh etj. Kjo formë e praktikës është parashikuar të zhvillohet në semestrin e dytë dhe të katërt të kursit.

Formimin e kompetencave shkencore, pedagogjike, metodologjike, didaktike, psikologjike, sociologjike, antropologjike, historiko-filozofike, të komunikimit dhe përdorimit të teknologjive të informacionit, të cilat do të përmbushin objektivat e arsimit në shoqërinë e dijes për punësim dhe për ruajtjen e vlerave kulturore e kombëtare.

Pajisjen e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në shërbimet për fëmijërinë e hershme, duke zbatuar teoritë dhe praktikën e të nxënës dhe të përkujdesjes, në lidhje me karakteristikat e grupmoshës, me veçoritë individuale të fëmijëve, me objektivat e arsimit gjithëpërfshirës, me përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin e edukatorit si profesionist në një kontekst social në ndryshim.

Aftësimin e studentëve për zgjidhjen e situatave problemore, për menaxhimin e mjedisit njohës, social, emocional dhe fizik të klasës.

Sigurimin e një konteksti akademik për diskutimin e çështjeve që lidhen me shkencat sociale dhe ato të edukimit, me synim zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve, zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të tyre me teknologjinë e informacionit, duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv të aftësive komunikuese, psiko-pedagogjike në lëndë të ndryshme, seminare dhe laboratorë.

Të aftësojnë studentët me shprehje teorike dhe praktike në aspektet e përkujdesjes dhe ndërhyrjeve drejtuar fëmijëve me nevoja të veçanta, me njohuri, shprehje edhe vlera në gjuhën e huaj dhe në praktikën mësimore të vëzhguar ose simuluar, në strukturat që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme dhe/ose në mjediset e universitetit.

Diploma profesionale **“Edukatore për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme”** mundëson hapin e parë drejt profesionit të edukatorit për grupmoshat 0–3 vjeç, për të punuar si në çerdhet shtetërore ashtu edhe në ato private, si dhe në të gjitha strukturat që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, duke iu përgjigjur sa më mirë tregut të punës. Sipas kriterëve përkatëse, mundësohet vazhdimi i studimeve në nivelin e parë Bachelor.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime të qëndrueshme teorike dhe praktike në fusha të ndërlidhura, të domosdoshme për formimin profesional të edukatorit. Këto fusha përfshijnë: zhvillimin e hershëm të fëmijës (0–3 vjeç), me theks në aspektet fizike, motorike, emocionale, sociale, gjuhësore dhe njohëse; psikologjinë e fëmijërisë së hershme; pedagogjinë dhe didaktikën e edukimit në moshat e vogla; metodologjitë e të mësuarit përmes lojës; komunikimin ndërpersonal dhe ndërinstitutional me fëmijët, familjet dhe profesionistët e tjerë; si dhe njohuritë bazë mbi kujdesin, higjienën, shëndetin dhe mbrojtjen e fëmijës.

Programi synon të zhvillojë te studentët një qasje gjithëpërfshirëse dhe reflektuese ndaj praktikës profesionale, duke përfshirë praktikën në institucione të kujdesit ditor, ndërveprimin me kontekste të ndryshme kulturore dhe sociale, si dhe njohjen e politikave bashkëkohore për mbrojtjen e fëmijëve dhe edukimin e hershëm.

Diploma profesionale **“Edukatore për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme”** mundëson hapin e parë drejt profesionit të edukatorit për grupmoshat 0–3 vjeç, për të punuar si në çerdhet shtetërore, ashtu edhe në ato private, si dhe në të gjitha strukturat që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, duke iu përgjigjur sa më mirë tregut të punës. Gjithashtu, mundësohet vazhdimi i studimeve në nivelin e parë Bachelor.

Në përfundim të këtij programi, jepet diploma profesionale **“Edukatore për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme” (0–3 vjeç)**. Lëndët dhe modulet e këtij programi studimi janë hartuar mbi bazën e arritjeve bashkëkohore të Universitetit të Janinës, Universitetit të Maqedonisë Perëndimore, Kozani – Greqi, Universitetit “Hasan Prishtina”, Kosovë, dhe përvojës së institucioneve të tjera që merren me foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm:**Psikologji në fëmijërinë e hershme; Pedagogji në fëmijërinë e hershme; Psikologji edukimi. **Kredite**18 ECTS
2. **Lëndë të formimit karakterizues:** Sociologji e përgjithshme; Gjithëpërfshirja në edukim; Antropologji kulturore; Histori e mendimit shqiptar; Modele të ndërmjetësimit didaktik; Formimi gjuhësor dhe komunikimi;Letërsi për foshnjërinë; Histori e teorive për foshnjërinë; Të mësuarit nëpërmjet. **Kredite** 54 ECTS
3. **Lëndë integruese:** Përkujdesjet mjekësore në fëmijërinë e hershme; Formimi trupor dhe metodologjia e lojës; Edukimi muzikor; Art pamor dhe didaktikë. **Kredite** 21 ECTS
4. **Lëndë me zgjedhje:** **Kredite** 3ECTS
5. **Lëndë të formimit plotësues:** Laborator informatike; Shkrim dhe menaxhim projekti ose Arte skenike; Praktikë mësimore profesionale:**Kredite** 21 ECTS
6. Provim i përgjithshëm përfundimtar /punim diplome. **Kredite** 6 ECTS

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64 pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 - 84 pikë
9 (nëntë)	85 - 94 pikë
10 (dhjetë)	95 - 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj profesionale në “**Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme**” (0–3 vjeç).” është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe professional për vazhdimin e edukimit zhvillimor për fëmijët e moshave 3-6 vjeç. Kurrikula jonë bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit. Detyra jonë më e rëndësishme është

përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë e një tregu pune në zhvillim, të ndërlidhur me kërkesat sociale, etike dhe profesionale që kërkon kujdesi dhe edukimi cilësor i fëmijëve në vitet e para të jetës.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë, ekspertë dhe edukatorë të profilizuar në fushën e edukimit të hershëm dhe zhvillimit të fëmijërisë, të kualifikuar me njohuri të tilla si zhvillimi i hershëm i fëmijës, pedagogjia dhe psikologjia e moshës së vogël, teknikat e ndërveprimit me fëmijët 0–3 vjeç, si dhe aftësi praktike për organizimin e mjediseve edukative gjithëpërfshirëse dhe të sigurta. Për këtë arsye, synimi i programit është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto profile profesionale që i kërkon tregu i punës në çerdhe, qendra komunitare, institucione private dhe publike që ofrojnë shërbime për fëmijët 0–3 vjeç.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në:

1. **Çerdhe publike dhe private**, si edukatorë të fëmijëve të moshës 0–3 vjeç.
2. **Qendra komunitare ose qendra për shërbime sociale**, që ofrojnë programe zhvillimi për fëmijët e vegjël.
3. **Institucione ose projekte që mbështesin familjen dhe prindërimin e hershëm**, si ndihmësedukatorë apo specialistë të fushës.
4. **Organizata joqeveritare dhe agjenci zhvillimi**, që veprojnë në fushën e edukimit të hershëm dhe mbrojtjes së fëmijëve.
5. **Si kujdestare fëmijësh profesioniste në familje**, me njohuri të mirëfillta për zhvillimin dhe edukimin e hershëm, duke ofruar një shërbim cilësor dhe të sigurt.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit 2-vjeçar me karakter profesional “Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3 vjeç)” fitojnë njohuri në:

- Zhvillimin fizik, kognitiv, emocional dhe social të fëmijëve të moshës 0–3 vjeç;
- Metodrat dhe teknikat e edukimit dhe ndërveprimit të hershëm;
- Organizimin e mjediseve edukative të sigurta dhe nxitëse;
- Komunikimin efektiv me fëmijët, familjet dhe profesionistët e tjerë;
- Planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve didaktike të përshtatura për moshën;
- Zbatimin e parimeve të gjithëpërfshirjes, etikës profesionale dhe kujdesit cilësor për fëmijët e vegjël.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT 2-VJEÇAR ME KARAKTER PROFESIONAL**“EDUKATORË PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME (0-3 vjeç)”**

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
VITI I PARË				
1.	Psikologji në fëmijërinë e hershme	6	150	1
2.	Pedagogji në fëmijërinë e hershme	6	150	1
3.	Psikologji edukimi	6	150	2
4.	Sociologji e përgjithshme	6	150	1
5.	Gjithëpërfshirja në edukim	7	175	1
6.	Antropologji kulturore	6	150	2
7.	Histori e mendimit shqiptar	6	150	2
8.	Modele të ndërmjetësimit didaktik	7	175	2
9.	Përkujdesjet mjekësore në fëmijërinë e hershme	6	150	2
10.	Laborator informatike	4	100	1
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
VITI I DYTË				
1.	Formimi gjuhësor dhe komunikimi	6	150	1
2.	Letërsi për foshnjërinë	5	125	1
3.	Histori e teorive për foshnjërinë	6	150	1
4.	Të mësuarit nëpërmjet lojës	5	125	2
5.	Formimi trupor dhe metodologjia e lojës	5	125	2
6.	Edukim muzikor	5	125	1
7.	Art pamor dhe didaktikë	5	125	1
8.	Prktikë mësimore profesionale	14	350	2
Lëndë me zgjedhje				
9.	1.Shkrim dhe menaxhim projekti	3	75	1
	2. Arte skenike	3	75	1
10.	Detyrime përmbyllëse	6	150	2
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500	
Total : Viti I + Viti II		120 ECTS	3000	

